

V E N D I M
Nr.373, datë 8.8.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.472, DATË 29.9.1993 “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHITETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT E STUDENTËT DHE FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHITËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË E NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE”

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Bursat dhe gjysmëbursat për vitet e para të shkollave 8 vjeçare, të mesme dhe të larta miratohen nga këshilli i bashkisë ose komunës ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi apo studenti, kurse për vitet e dyta nga vetë shkollat dhe fakultetet me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.472, datë 29.9.1993 dhe kushteve ekonomike të përcaktuara në pasqyrën nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Përjashtimisht për vitin arsimor 1994-1995, nxënësit dhe studentët e viteve të treta e lart do të gëzojnë të drejtën e bursës apo gjysmëbursës që kanë patur sipas listave të vitit shkollor 1993-1994.

2. Kushtet ekonomike për dhënien e bursës, niveli i kuotës financiare të ushqimit dhe norma e veshmbathjes janë sipas pasqyrave nr.1,2 dhe 4 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

3. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitin e parë e lart për gjithë kategoritë e shkollave dhe institucioneve është data 20 tetor 1994.

4. Kuota financiare për efekt burse mbetet ajo e përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.472, datë 29.9.1993. Diferenca ndërmjet kuotës së ushqimit të përcaktuar në këtë vendim dhe asaj financiare për efekt burse për të gjithë nxënësit e studentët që trajtohen në mensa përballohet nga shteti.

5. Efekti ekonomik që rrjedh nga idenksimi i kuotës financiare të ushqimit prej 22 milionë lekë, për 4-mujorin e tretë të vitit 1994, të përballohet nga buxheti i miratuar për arsimin për vitin 1994.

Për këtë, Ministrisë së Arsimit në buxhetin e vitit 1994 i pakësohet shuma 13 milionë lekë e cila i shtohet Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë.

6. Kostoja ushqimore të rritet aq sa është inflacioni vjetor.

7. Për vitin shkollor 1994-1995, Ministrisë së Arsimit i jepen 1700 bursa, për vitet e para.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.546, datë 15.11.1993, nr.582, datë 6.12.1993, pika 9 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.472, datë 29.9.1993 dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KUSHTET EKONOMIKE PËR DHËNIEN E BURSAVE NXËNSËVE E STUDENTËVE

Nr. R	Përbërja familjare	Të ardhura për frymë në familjet e nxënësve		Të ardhurat për frymë në familjet e studentëve			
		Bursë	Gjysmëbursë	Me pagesë	Bursë	Gjysmëbursë	Me pagesë
Për qytetin							
1.	Për familjet me 2 persona	deri 970	mbi 970-1655	mbi 1655	deri 1296	mbi 1296-1980	mbi 1980
2.	" " 3 "	" 774	" 774-1464	" 1464	" 1098	mbi 1098-1788	" 1788
3.	" " 4 "	" 762	" 762-1440	" 1440	" 1025	mbi 1025-1764	" 1764
4.	" " 5 "	" 708	" 708-1392	" 1392	" 940	mbi 940-1716	" 1716
5.	" " 6 "	" 648	" 648-1344	" 1344	" 860	mbi 860-1668	" 1668
6.	" " 7 "	" 612	" 612-1308	" 1308	" 820	mbi 820-1632	" 1632
7.	" " 8 "	" 540	" 540-1236	" 1236	" 790	mbi 790-1560	" 1560

Për fshatin:

Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja fshatare fiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70% të bursës, kur fiton ndihmë ekonomike të pjesësme, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993, gjithë të tjerat do të trajtohen me pagesë.

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES

Nr.R.	Emërtimi	Kuota në lekë për një vit shkollor
1.	Për fëmijët e shtëpive të fëmijës të moshës parashkollore	2500
2.	Për fëmijët e shtëpisë së fëmijëve të moshës shkollore dhe të instituteve të nxënësve që nuk dëgjojnë, nuk flasin e nuk shikojnë	3500
3.	Për jetimët e shkollave të mesme e të larta.	5000

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIM TË
NXËNËSVE E STUDENTËVE**

Nr. R	Emërtimi	Njësia e matjes	Çmimi mesatar për kg.	Nxënës		Studentë	
				Norma ditore gr.	Vlefia	Norma ditore gr.	Vlefia
1.	Bukë	gram	24.2	700	16.94	600	14.52
2.	Makarona	"	46	40	1.84	30	1.38
3.	Oriz	"	36	40	1.44	30	1.08
4.	Fasule	"	40	65	2.60	35	1.40
5.	Patate	"	25	-	-	200	5.00
6.	Perime	"	30	300	9.00	300	9.00
7.	Fruta	"	40	-	-	50	2.00
8.	Sheqer	"	46	25	1.15	55	2.53
9.	Vaj	"	90	25	2.25	30	2.70
10.	Gjalpë	"	157	20	3.14	15	2.35
11.	Mish	"	220	90	19.80	100	22.00
12.	Qumësht	"	30	-	-	250	7.50
13.	Djathë	"	180	30	5.40	40	7.20
14.	Vezë	kokrra	6	-	-	1/2	3.00
15.	Reçel	gram	100	-	-	40	4.00
16.	Marmalatë	"	60	30	1.80	-	-
17.	Të tjera					0.64	- 0.34
Kuota ditore				66		86	
" mujore				1980		2580	

KUOTA DITORE USHQIMORE E NXËNËSVE DHE STUDENTËVE
SIPAS KATEGORIVE TË SHKOLLAVE

Nr. Kategoritë e shkollave R		Kuota ditore ushqimore	
		Ishte	Bëhet
1. Shkolla 8-vjeçare e të mesme	51	66	
2. Shkolla e Mjeshtërisë Sportive		67	87
3. Shkolla e Futbollit		85	110
4. Shkolla e Baletit dhe vegla frymore		51	66
5. Studentë të Shkollave të larta	65	86	
6. Studentë të ILKF “Vojo Kushi”		69.40	90
7. Nxënës të shkollave të tjera		51	66